

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi:	Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobileve
Titulli:	Gjuhë angleze I
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javëL	2
Vlera në kredi - ECTS:	3
Koha/ vendi:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	Anylë Shala
Detajet kontaktuese:	anyla.shala@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës:	Lënda "Gjuhë angleze I" do të pajisë studentët me shkathtësi dhe njohuri bazë të të shkruarit, lexuarit, komunikimit oral në gjuhën angleze dhe të dëgjuarit. Libri bazë që do të përdoret gjatë ligjëratave është "Global Pre-intermediate" përmes së cilit jo vetëm do të zhvillohen shkathtësitë e lartpërmendura, por edhe do të ushtrohen leksiku e gramatika e gjuhës angleze.
Qëllimet e lëndës:	Përmes ligjëratave, ushtrimeve, dhe diskutimeve të ndryshme në klasë synohet që studentëve t'u ofrohen mundësi të zgjerojnë e përforcojnë njohuritë rreth gramatikës së gjuhës angleze, por edhe të pasurojnë leksikun dhe mënyrën e tyre të të shprehurit në këtë gjuhë. Theks i veçantë gjatë aktiviteteve në klasë do të vihet mbi mendimin kritik dhe bashkëpunimin me të tjerët.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të modulit studenti do të jetë i aftë që: <ul style="list-style-type: none"> •të zhvillojë biseda të shkurtëra në gjuhën angleze duke përdorur gjuhë dhe fjalor të përshtatshëm dhe adekuat, •të identifikojë dhe kuptojë idetë kryesore të teksteve të ndryshme në gjuhën angleze, •të dëgjojë dhe kuptojë biseda të thjeshta në gjuhën angleze, •të shkruaj lloje të ndryshme tekstesh në gjuhën angleze në formë të paragrafeve që kanë përmbajtje dhe strukturë të rrjedhshme dhe të qartë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Activity	Hour	Day/Week	In total
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	0	0	0
Kollokfiume, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezentimet, etj.	1	2	5
Totali			77
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Metoda me të cilën do të punohet gjatë ligjëratave është ajo komunikuese, meqë mendohet të jetë metoda më e suksesshme e mësimit të gjuhëve të huaja. Kjo qasje u mundëson studentëve që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre gjuhësore në disa forma, si p.sh. me pyetje dhe përgjigje, diskutime mes vete, apo duke bërë përshkrime, krahasime e kërkesa tëndryshme.		
Metodat e vlerësimit:			
	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 5% - Presentation: 10% - Testi gjysmësemestral: 25% - Testi përfundimtar, Provimi: 60% 		
Literatura			
Literatura bazë:	Global. Pre-Intermediate Coursebook by Lindsay Clandfield, with additional material by Amanda Jeffries. Macmillan Education, 2010.		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Global. Pre-Intermediate Workbook by Julie Moore, with additional material by Rob Metcalf. Macmillan Education, 2010. 2. Discussions A-Z Intermediate: A Resource Book of Speaking Activities by Adrian Wallwork. Cambridge University Press, 1997. 		
Raporti i teorisë dhe praktikës:	Teori: 30%; Praktikë: 70%		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Introduction to the course, discussion of the syllabus and the necessary materials
Java e dytë:	Individual & Society Word order in questions; What and How questions; Present simple, frequency adverbs; Present continuous
Java e tretë:	Eating & Drinking Countable/ uncountable nouns, quantifiers (some, any); Quantifiers (a lot of, a little, a few, not enough, much, many) The infinitive; The infinitive of purpose
Java e katërt:	Art & Music Past simple and past continuous; Used to
Java e pestë:	Hopes & Fears Future hopes and plans; Future plans and intentions (be going to, present continuous) Prediction and ability (will, be able to) Future time clauses
Java e gjashtë:	Work & Leisure Have; Modal verbs; -ing verbs; Present perfect, have been/ have gone
Java e shtatë:	Science & Technology Comparatives with -er and more; Comparatives (a bit/ much/ as ... as) Superlatives; Phrasal verbs and objects
Java e tetë:	Testi gjysmësemestral
Java e nëntë:	Time & Money Present perfect with for and since Present perfect with yet and already
Java e dhjetë	Home & Away Passive voice First conditional; Second conditional
Java e njëmbëdhjetë:	Health & Fitness Modal verbs of advice; could/ couldn't, had to/ didn't have to Past perfect; Reported statements
Java e dymbëdhjetë:	New & Old Defining relative clauses; Definite article
Java e trembëdhjetë:	New & Old (Part II) Verb form review; Both, neither
Java e katërbëdhjetë:	Additional material Speaking, reading & grammar focus
Java e pesëmbëdhjetë:	Review of the covered material, preparation for the final exam

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet dhe të kenë me vete materialin e nevojshëm me qëllim të realizimit sa më të mirë të ligjëratave dhe përfshirjes së tyre në procesin mësimor. Studentët duhet të vijnë me kohë në ligjërata, të mbajnë qetësinë dhe të marrin pjesë në diskutimet e aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në klasë.